



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:048515

Datë: 10.04.2024

Numri i dokumentit: 05684593

KE.nr.2595/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike të paditësit "EURO ABI" Sh.P.K., me seli në fshatin Mogillë, Komuna e Vitisë, me NRB: 70038769, të cilin e përfaqëson avokat Abdylaziz Sadiku me seli të zyrës në Gjilan, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e Financave - Administrata Tatimore e Kosovës, me objekt kontesti kompensim i dëmit (çështja në rivendosje), vlera e kontestit 9,103.22 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 26.03.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të të paditurës, me datë 10.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit "EURO ABI" Sh.P.K., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës - Ministria e Financave - Administrata Tatimore e Kosovës, që në emër të kompensimit të dëmit, t'ia paguaj paditësit shumën prej 9,103.22 € (nëntë mijë e njëqind e tri euro e njëzet e dy cent).
- II. Secila palë i bartë shpenzimet procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi "EURO ABI" Sh.P.K., pranë gjykatës, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e Financave - Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit në shumën prej 9,103.22 €, për shkak të përmbarimit të kundërligjshëm

në pronën e paditësit, me arsyetimin se personi zyrtar i të paditurës me veprim arbitrar e pa kurfarë akti me shkrim për paralajmërim, pa prezencën e pronarit të Sh.P.K “Euro Abi” dhe pa bërjen e regjistrimit të të gjitha të mirave materiale, i ka konfiskuar në atë mënyrë që i ka larguar punëtorët dhe rojën e objektit nga vendet e punës e pastaj e ka vendosur shiritin për bllokimin e fabrikës dhe oborrit të saj.

Gjykata Themelore në Gjilan – dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr.61/2006, ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, ku në pikën I ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të dëmit të shkaktuar nga e paditura me rastin e përmbarrimit në mënyrë kundërligjore, t’ia paguajë shumën në vlerë prej 9,103.22 Euro, me kamatë prej 8 % duke filluar nga data 22.11.2017 e deri në pagesën përfundimtare, nën kanosje të përmbarrimit me dhunë. Po ashtu ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën prej 2,480.00 Euro, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kanosje të përmbarrimit më dhunë. Në pikën II ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për shpenzimet e procedurës për shumën prej 965 Euro si të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës, duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së palës së paditur, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1/2022 të datës 13.10.2022, ka aprovuar si të themeltë ankesën e të paditurës Qeveria e Kosovës – Administrata Tatimore e Kosovës, dhe ka prishur aktgjykimin e lartcekur andaj lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe precizimit të kërkesëpadisë, duke theksuar se personi zyrtar i të paditurës me veprim arbitrar e pa kurfarë akti me shkrim për paralajmërim, pa prezencën e pronarit të Sh.P.K “Euro Abi” dhe pa bërjen e regjistrimit të të gjitha të mirave materiale duke nënkuptuar edhe makinat e prodhimit si dhe automjetet transportuese – kamionin transportues dhe gjipin e udhëtarëve i ka konfiskuar në atë mënyrë që i ka larguar punëtorët dhe rojën e objektit nga vendet e punës e pastaj e ka vendosur shiritin për bllokimin e fabrikës dhe oborrit të saj. Më tej ka theksuar se ATK-ja ka qenë e obliguar që të hetojë në detaje pronësinë e borxhliut dhe nga ai t’i kërkojë borxhet, dhe nuk është arsye për të kërkuar borxhin nga operatori jo-borxhli për faktin se ata i paskan pasur zyret/administratën në të njejtin objekt dhe sot në praktikë ka raste të tilla që me një objekt janë dy vëllezër, motra apo më gjerë por secili duhet të përgjigjet

për vetveten, nuk ka dispozitë ligjore që e bën të obligueshme për t'u përgjigjur për dikë tjetër. Andaj, mbi bazën e këtyre ka kërkuar aprovimin e kërkesëpadsisë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e palës paditëse me arsyetimin se është fakt i pakontestueshëm që paditësit nuk i kanë kryer obligimet tatimore që kanë qenë të obliguar t'i paguajnë në bazë të qarkullimit real në kuadër të veprimtarisë së tij, dhe ATK-ja në bazë të ligjit në fuqi, për shkak se paditësi me pronarin e subjektit "Arbëri 93" Shefik Rexhepi janë vëllezër, në harmoni me ligjin e ATK-së dhe procedurat në nenin 1 kanë bërë konfiskimin e një veture, 51 thasë sheqer dhe 3 makinë larëse, për faktin se ka qenë një seli një pronë e përbashkët, një objekt i përbashkët, dhe vet paditësi K.R. në prezencën e inspektorëve ka deklaruar se është pronar i të gjitha bizneseve dhe përgjigjet për të gjitha. Ka shtuar se të gjitha veprimet e të paditurës në këtë objekt kontesti janë kryer në zbatim të legjislacionit tatimor. I ka propozuar gjykatës që në tërësi ta refuzojë në tërësi padinë dhe precizimin e kërkesëpadsisë si dhe shpenzimet procedurale të bien në barrë paditësit e jo të paditurës e cila ka qenë në zbatim të legjislacionit tatimor.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata në rivendosje, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor bëri administrimin e provave si në vijim:

- Raporti i ATK-së me Nr.0504 i datës 22.10.2004;
- Lista e pasurisë së konfiskuar e lëshuar nga ATK-ja e datës 16.09.2005;
- Dy raportet e ATK-së për sendet e mbetura në depo të datës 21.11.2005;
- Raporti lista e pasurisë së konfiskuar i datës 16.11.2005;
- Procesverbali me Nr.61/2006 i mbajtur në orën 13:30;
- Raportet për borxhin e falur të "Euro Abit" Sh.P.K., dhe N.P.Sh. "Arbri 93";
- Ekspertiza financiare e datës 05.07.2017 nga eksperti I.T.;
- Raporti i datës 23.02.2006 nga Regjioni për Krime Ekonomike.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Në rastin konkret rezulton se për asnjërën palë ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se e paditura në procedurë përmbarimore i kishte konfiskuar paditësit sendet dhe atë: 1 kamion të markës “Mercedes”, 71 thasë sheqer, 3 makina për larje të enëve të markës “Konçar”, 2 piruna për matjen e peshës (ngarkesës), dhe 1 aparat saldues.

Në rastin konkret, kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte çështja lidhur me faktin nëse obligimet tatimore kanë qenë të një subjekti tjetër, përkatësisht nëse paditësi është ngatërruar me subjektin tjetër me ç’rast i janë konfiskuar sendet nga e paditura.

-Nga Raporti i ATK-së me Nr.0504 i datës 22.10.2004, konstatohet se nga data 06.08.2004 deri me datën 22.10.2004, e paditura Administrata Tatimore e Kosovës ka realizuar kontroll tek paditësi “Euro Abi” Sh.P.K., me seli në Viti, me pronar K.R., ku sipas raportit e paditura ka dështuar t’i regjistrojë D.U.D-at (dokumenti unik doganor) në librin e blerjes Nr.8773 i datës 31.12.2003, Nr.5541 i datës 26.02.2004, Nr.14723 i datës 28.04.2004.

-Nga Lista e pasurisë së konfiskuar e lëshuar nga ATK-ja e datës 16.09.2005, gjykata konstaton se e paditura ka konfiskuar pasurinë e subjektit “Arbëri 93”: dhe atë: çelësi i derës kryesore, çelësi i derës (zyre), çelësi i zyrës (depo), çelësi i veturës BMW, BMW X5 (2003 i pa doganuar), çelësi i kamionit (471-KS-892), Mercedes 1987, konfiskimi i depos 700 m².

-Nga dy raportet e ATK-së për sendet e mbetura në depo të datës 21.11.2005, gjykata konstaton se e paditura ka konfiskuar sendet e mbetura në depo të “NTP Arbëri” dhe atë: 2 rezervuar të mëdhenj alumini, 1 rezervuar hekur, 1 bure ulje, 1 kompresor, 1 kolicë e vjetër, 1 makinë për larjen e automjeteve, 19 bure, 8 element hekuri (rrethojë), 1 golf 2 ngjyra e kuqe (...), 1 hidrofor, 1 trafo e rrymës, 1 makinë për armaturë, 7 shtylla të cimento, 33 shufra armaturë 12 cm, 1 rezervuar i kamionit, 1 kontejner, 2 krevate të fjetjes, si dhe sendet tjera të përshkruara si në raport.

-Nga Raporti lista e pasurisë së konfiskuar i datës 16.11.2005, gjykata konstaton se e paditura ka konfiskuar tek subjekti “Arbëri 93” 1 veturë të tipit BMW, 1 Kamion të tipit Mercedes, 71 thasë sheqer, dhe 3 makina për larjen e enëve.

-Nga Raportet për borxhin e falur të “Euro Abit” Sh.P.K., dhe N.P.Sh. “Arbëri 93”, gjykata konstaton se borxhi i falur për paditësin “Euro Abi” Sh.P.K., nga e paditura është në shumën prej 313,190.06 Euro, ndërsa për subjektin N.P.Sh “Arbëri 93” borxhi i falur nga e paditura është në shumën prej 56,345.18 Euro.

-Nga Ekspertiza financiare e datës 05.07.2017 nga eksperti I.T., gjykata konstaton se është bërë llogaritja e vlerës së mjeteve të konfiskuara, dhe atë: Kamioni Mercedes Benz 1217 B, viti i prodhimit 1981, është vlerësuar në shumë prej 2,700.00 Euro, Makina larëse e enëve (Konçar) është vlerësuar në shumë prej 660.00 Euro, 71 thasë sheqer janë vlerësuar në shumë prej 1,704.00 Euro, dhe Piruni peshëngritës është vlerësuar në shumë prej 450.00 Euro, të gjitha këto në vlerën bazë në shumë prej 5,514.00 Euro, ndërsa kamata ligjore prej 8 % në vit nga periudha 01.01.2013-05.07.2017 është llogaritur në shumë prej 3,589.22 Euro, të gjitha këto në shumën e përgjithshme në vlerë prej 9,103.22 Euro.

-Nga Raporti i datës 23.02.2006 i Njësitit për Krime Ekonomike të Policisë së Kosovës-Regjioni i Prishtinës, gjykata konstaton se Automjeti BMW me ngjyrë të zezë me numër të shasisë WBAFA101LK74558 i sekuestruar nga Administrata Tatimore e Kosovës dega-regjioni i Gjilanit, është paraqitur si i vjedhur në Gjermani me datën 07.06.2004.

Nga provat e administruara si prova si me larte gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Raporti lista e pasurisë së konfiskuar i datës 16.11.2005, gjykata vërteton se e paditura ka konfiskuar tek subjekti “Arbëri 93” 1 veturë të tipit BMW, 1 Kamion të tipit Mercedes, 71 thasë sheqer, dhe 3 makina për larjen e enëve, po ashtu gjykata vërteton se nga dy raportet e ATK-së për sendet e mbetura në depo të datës 21.11.2005, e paditura ka konfiskuar sendet e mbetura në depo të “NTP Arbëri” dhe atë: 2 rezervuar të mëdhenj alumini, 1 rezervuar hekur, 1 bure ulje, 1 kompresor, 1 kolicë e vjetër, 1 makinë për larjen e automjeteve, 19 bure, 8 element hekuri (rrethojë), 1 golf 2 ngjyra e kuqe (...), 1 hidrofor, 1 trafo e rrymës, 1 makinë për armaturë, 7 shtylla të çimentos, 33 shufra armaturë 12 cm, 1 rezervuar i kamionit, 1 kontejner, 2 kravatë të fjetjes, si dhe sendet tjera të përshkruara si në raport. Prandaj gjendja e konstatuar faktike tregon se paditësi nuk ka mundur të argumentoj me asnjë provë se malli i konfiskuar ka qenë në pronësi

të tij, por nga provat e administruar vërtetohet se malli i konfiskuar ka qenë në pronësi të Arbëri 93 me pronar Shefki Rexhepi me numër të biznesit të verifikuar në ARBK 80081570, e jo në pronësi të paditësit Euro Abi me pronar K.R. me numër të biznesit 70038769 po ashtu të verifikuar nga ARBK-ja. Këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga shkresat e lëndës dhe të dhënat në ARBK me të cilat vërehet se këto biznese kanë subjektivitet të ndarë dhe të dyja ushtroj afarizëm të ndarë pavarësisht lidhjeve farefisnore në mes të pronareve.

Gjatë administrimit të shkresave të lëndës, gjykata konstaton se lidhur me dëmin e shkaktuar nga e paditura Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka ndonjë lidhje konkrete e direkte me dëmin e shkaktuar paditësit, ashtu që nga veprimi apo mosveprimi i saj nuk mund aludohet se është shkaktuar dëmi i pretenduar i paditësit. Pas vlerësimit të pretendimeve të palëve në procedurë, dhe deklarimeve të përfaqësuesit të të paditurës në seancat e mbajtura, Gjykata konstaton se e paditura ka konfiskuar mallin tek Kompania Arbëri 93 me numër të biznesit 8001570 e cila ka pasur në pronësi sendet e konfiskuara nga e paditura (ATK-ja), por nuk ka konfiskuar sendet në pronësi të paditësit Euro Abi Shpk me numër të biznesit 70038769. Gjithashtu nga provat e administruara në bazë të konstatimit të Raporteve të ATK-së të paditurës është evidentuar konfiskimi i sendeve mirëpo nuk është vërtetuar se dëmi cili me veprimet apo mosveprimet e tij/saja e paditura i ka shkaktuar dëm paditësit.

Duke bazuar në të lartcekurat, gjykata gjeti se në rastin konkret padia është ushtruar nga subjekti i cili nuk është titullar i sendeve mbi objektin kontestues e rrjedhimisht nuk mund të jetë bartës i të drejtave/kërkesave që mund të dalin lidhur me ato sende. Po ashtu gjykata gjeti se e paditura nuk ka asnjë detyrim ligjor ndaj paditëses, respektivisht paditësja dhe i padituri nuk gjinden në kurrfarë raporti materialo-juridik, nga i cili do të krijoheshin të drejta dhe detyrime ndërmjet tyre, prandaj gjeti se të paditëses i mungon legjitimiteti real respektivisht i mungon legjitimiteti (aktiv) për të qenë palë në këtë kontest.

Andaj në bazë të të lartcekurave, në kuptim të nenit 253 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata konstatoi se të paditurës i mungon legjitimiteti real aktiv për të qenë palë në procedurë.

Lidhur me provat dhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse në këtë kontest, të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata nuk u thellua në administrimin dhe vërtetimin e tyre sepse nga

të lartcekurat – gjeti se të njëjtat ishin të mjaftueshme për vendosjen e rastit. Prandaj nga sa u theksua në këtë arsytim, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale të shkaktuara në këtë kontest, si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata e vendosi në bazë të dispozitës së nenit 450 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Andaj duke marrë parasysh elaborimet e theksuara si më sipër, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2595/22, datë 10.04.2024

Gjyqtari:

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.